



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 361-482.1 /2023

Klinë, datë 13 / 07 /2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare, nr.28 me dt.04.06.2008, Strategjinë Zyrës së Kryeministrit- Zyrës për Qeverisje të Mire për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës, si dhe shkresën e MAPL-së për themelimin e komiteteve komunale vepruese, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

V E N D I M

Për themelimin e komitetit komunal veprues

1. **THEMELOHET**, Komiteti Komunal Veprues për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve Rome dhe Ashkali dhe Planit të Veprimit, për periudhë 2022-2026.

Përbërja e komitetit është si në vijim:

- 1.1. Qemajl Sejdiu, Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim;
 - 1.2. Agron Bacaj, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.3. Enver Berisha, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
 - 1.4. Halil Kerellaj, Zyrtar Komunal për Komunitete dhe Kthim;
 - 1.5. Have Thaqi, Zyrtare për Integritet Evropian;
 - 1.6. Vitore Shala, Zyrtare për Barazi Gjinore;
 - 1.7. Butrint Kryeziu, Zyrtar nga Drejtoria e Financave;
 - 1.8. _____, përfaqësues nga OJQ;
 - 1.9. _____, përfaqësues nga OJQ;
 - 1.10. _____, përfaqësues nga OJQ;
 - 1.11. _____, përfaqësues nga OJQ.
2. Vendet e lira të parapara për OJQ si nga pika 1.8 deri 1.11 do të plotësohen sipas konkursit publik më përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.
 3. Komiteti Komunal Veprues udhëhiqet nga kryetari i komunës e në mungesë të tij nga nënkryetarja.
 4. **Ajet Sejdiu**, emërohet, koordinator i komitetit komunal veprues.
 5. Detyrat e Komitetit Komunal Veprues (KKV) dhe të koordinatorit të komitetit janë të përcaktuara në Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore.
 6. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Të përmendurit;
- MAPL;
- Zyra për qeverisje të mire ZK;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

